



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

Nr 16211/6 Prot, datë 5.06. 2013

MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr 1250/2 Prot, datë 03.11. 2013

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr 2760/4 Prot, datë 15.04. 2013

MINISTRIA E BRENDSHME

Nr 940/1 Prot, datë 14.02. 2013

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

“Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”

DUKE MARRË NË KONSIDERATË

- Qëllimin e përbashkët për forcimin e shtetit ligjor, mbrojtjen e interesave të shtetit, ruajtjen e sigurisë kombëtare, luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit të organizuar në përgjithësi.

ME SYNIMIN PËR

- Të arritur një përmirësim të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional, sidomos në kuadër të shkëmbimit dhe rakordimit të statistikave në çdo fazë të bashkëpunimit dhe ndërveprimit për çështje që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- Të arritur rishikimin periodik të efektivitetit dhe frytshmërisë së sistemit vendas për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Të arritur një përfaqësim sa më profesional dhe dinjitoz të vendit tonë në strukturat ndërkombëtare në të cilat periodikisht raportojmë.

DUKE JU REFERUAR

- Gërmave “ë” dhe “ll” të nenit 22 të ligjit nr.9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, i cili, ndër të tjera, ngarkon Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (në vijim referuar si DPPPP) me:
 - a) mbajtjen e statistikave të plota dhe raportimin për procedimet penale të regjistruara për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprave penale ose veprimtarisë kriminale dhe financimit të terrorizmit si dhe për mënyrën e përfundimit të tyre;
 - b) me rishikimin e efektivitetit dhe frytshmërisë së sistemit vendas për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke kërkuar statistika dhe të dhëna nga autoritetet kompetente që janë të ngarkuara për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Rekomandimeve ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të dhëna nga Bashkimi Europian dhe Komiteti MONEYVAL.

Biem dakord si më poshtë:

I. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim referuar si *DPPSH*), informon DPPPP në lidhje me:

1. Ecurinë e rasteve të dyshimta të dërguara nga DPPPP:
 - a) Rastet që janë në hetim policor dhe ato që janë referuar në Prokurori;
 - b) Numrin e rasteve për të cilat informacioni i dërguar nga DPPPP ka shërbyer si indicie për hetime të tjera veprash penale që nuk kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, por me vepra të tjera penale;
 - c) Numrin e rasteve për të cilat DPPSH-së i janë deleguar veprime procedurale nga Prokuroria për çështje të referuara nga DPPPP drejtëpërdrejtë të kjo e fundit.
2. Numrin e rasteve që DPPSSH, me indicie të saj, ka referuar në Prokurori në lidhje me veprat penale të parashikuara në nenet 230/a, 230/b, 230/ç, 179/a dhe 287/b të Kodit Penal (Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar), të ndara për secilin nen dhe duke përfshirë edhe numrin e personave të referuar për secilën vepër penale.
3. Numrin e referimeve të dërguara nga DPPSSH (me indicie të saj) në Prokurori, mbi bazë të nenit 287 të Kodit Penal, duke saktësuar, përveç numrit të personave të përfshirë, edhe:
 - a) nëse personi që është referuar është i njëjtë me personin që ka kryer veprën nga e cila kanë rrjedhur produktet;
 - b) në sa prej tyre personi që kryen veprën është i ndryshëm nga ai që ka kryer veprën nga ku kanë rrjedhur produktet;
 - c) veprën e origjinës nga ku dyshohet se kanë rrjedhur produktet.
4. Numrin e rasteve që DPPSSH (të ndarë sipas indicies) ka referuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, bazuar në ligjin nr.10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", për fushën e zbatimit që lidhet me kryerjen e veprave me qëllime terroriste (të parashikuara në pjesën e posaçme kreu VII i Kodit Penal) dhe nenin 287 të Kodit Penal.

II. Prokuroria e Përgjithshme, për veprat penale të parashikuara në nenet 230/a, 230/b, 230/ç, 179/a, 287 dhe 287/b të Kodit Penal, me ndarje sipas Prokurorive të Rretheve apo Krimeve të Rënda, informon DPPPP në lidhje me:

1. Numrin e procedimeve penale të rregjistruara dhe ato të pushuara, duke saktësuar nga është marrë indicia për to;
2. Veçanërisht për procedimet penale të rregjistruara për nenin 287 të Kodit Penal, duke saktësuar, përveç numrit të personave të përfshirë, edhe:
 - a) Nëse personi që është referuar është i njëjtë me personin që ka kryer veprën nga e cila kanë rrjedhur produktet;
 - b) Në sa prej tyre personi që kryen veprën është i ndryshëm nga ai që ka kryer veprën nga ku kanë rrjedhur produktet;
 - c) Veprën e origjinës nga ku dyshohet se kanë rrjedhur produktet.
3. Numrin e rasteve që janë në hetim;
4. Numrin e rasteve për të cilat është vendosur mosfillimi;
5. Numrin e rasteve të çuara për gjykim;

6. Mënyrën e përfundimit të çështjes në gjykatë;
7. Pasuritë e sekuestruara apo konfiskuara, të ndara për çështje dhe procedim penal apo pasuror.

Informacioni statistikor nga Prokuroria e Përgjithshme do të jepet në përputhje me formularin “Modeli Tip Prokuroria”, bashkëlidhur kësaj marrëveshje.

III. Ministria e Drejtësisë. për veprat penale të parashikuara në nenet 230/a, 230/b, 230/ç, 179/a, 287 dhe 287/b të Kodit Penal, informon DPPP në lidhje me:

1. Numrin e vendimeve gjyqësore të dhëna dhe të personave të dënuar, nga gjykatat në shkallë vendi sipas ndarjes së tyre;
2. Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike, me shtete të tjera dhe për bashkëpunim ndërkombëtar në këtë fushë.

IV. Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, informon dy herë në vit secilin institucion për konkluzionet për frytshmërinë dhe efikasitetin e sistemit vendas për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që del nga shqyrtimi dhe analizimi i të dhënave statistikore të marra nga institucionet e përfshira, në harmoni me të dhënat e tjera të grumbulluara nga DPPP.

V. Afatet e dërgimit të të dhënave

Të dhënat e mësipërme raportohen çdo tre muaj.

VI. Afati i kohëzgjatjes së memorandumit

Ky memorandum bashkëpunimi është i vlefshëm për dy vjet nga firmosja e tij dhe ripërtërihet automatikisht për dy vjet të tjera në rast se palët nuk shprehin kundërshti me shkrim.

VII. Hyrja në fuqi

Ky memorandum bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit të tij nga titullarët e institucioneve.

PËR MINISTRINË E FINANCAVE
MINISTRI

RIDVAN BODE

PËR MINISTRINË E DREJTËSISË
MINISTRI

EDUARD HALIMI

PËR PROKURORINË E PËRGJITHSHME
KRYEPROKURORI

ADRIATIK LLALLA

PËR MINISTRINË E BRENDSHME
MINISTRI

FLAMUR NOKA